



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.10.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik Sfinga SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me çanta shpinore për shuarjen e zjarrit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-9900-1-3-6, Nr. i brendshëm-632-24-112-136, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik Sfinga SH.P.K, e dt.14.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me çanta shpinore për shuarjen e zjarrit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-9900-1-3-6, Nr. i brendshëm-632-24-112-136, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 08.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 08.10.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik Sfinga SH.P.K me dt.14.10.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me çanta shpinore për shuarjen e zjarrit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-9900-1-3-6, Nr. i brendshëm-632-24-112-136. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, ka vendosur që të bëj anulimin e aktivitetit të prokurimit "Furnizimi me çanta shpinore për shuarjen e zjarrit", Nr. i prokurimit- 632-24-9900-1-3-6, Nr. i brendshëm-632-24-112-136, sepse të gjithë Operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë qenë të papërgjegjshëm dhe nuk kanë plotësuar kërkesat e Autoritetit Kontraktues në FDT-ë.

Ju si Operator ekonomik, keni ofruar katalogun e kompanisë Vallfirest, por në bazë të specifikimeve teknike në katalog të njëjtat nuk përputhen me specifikimet teknike në dosje të tenderit dimensionet, pesha etj (64x50x5cm, ndërsa të kërkuara janë 62x42x5), prandaj pretendimet e juaja nuk qëndrojnë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit

